



## REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova–Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION  
GJAKOVË - DAKOVICA

AD.nr.01/2025

Dt.24.03.2025

Gj a k o v ë

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Gjakovë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] – avokati [REDACTED] nga [REDACTED], ndaj prokurorit së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDACTED], lidhur me trajtimin e çështjes penale PP/II.nr. [REDACTED], konform nenit 9 par.1 pika.1.5 dhe par.6 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7 par.3 të Rregullores për procedurën disiplinore të prokurorëve, merr këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHEȚ si e pa bazuar** ankesa e paraqitur nga përfaqësuesi i të dëmtuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED] – avokati [REDACTED] nga [REDACTED], ndaj prokurorit së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDACTED], sepse nuk ekzistojnë shkelje disiplinore nga neni 6 par.1 dhe 2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### A r s y e t i m

Stacioni Policor Malishevë, ka paraqitur kallëzim penal kundër [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED], për shkak të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED] – avokati [REDACTED] nga [REDACTED], ka paraqitur ankesë, respektivisht kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorit së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDACTED], duke cekur ndër tjera se prokurori ka neglizhuar këtë çështje dhe nuk ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe pala ende nuk ka marr përgjigje lidhur me këtë çështje, ende nuk është ngritur aktakuzë.

### *Veprimet e autoritetit kompetent;*

Pas pranimit të ankesës, janë analizuar në hollësi të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, po ashtu duke vepruar konform nenit 9 par.5 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga prokurori është kërkuar raport me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra në këtë çështje penale dhe pretendimet e paraqitura në ankesë.

Prokurori i çështjes, ka paraqitur raportin me shkrim, ndër tjera duke cekur: se në fillim të vitit 2024 ka startuar me mbi 400 lëndë të rregullta, e më pas ka pranuar mbi 250 lëndë të reja, ashtu që gjatë këtij viti në punë kanë qenë rreth 700 lëndë, prej të cilave janë punuar afér 400 lëndë, i cili fakt tregon mbingarkesën e punës, pastaj në këtë çështje me dt.11.04.2024 ka nxjerrë vendim pér akt ekspertizë mjeko ligjore, në bazë të kërkesës së av. [REDACTED], të njëjtit i është fotokopjuar i tërë kallëzimi penal dhe është njoftuar, përveç të tjerave edhe me ekzaminimin mjeko ligjore, fakt i cili vërtetohet me fletë dërgesën pér dorëzim personal të dt.16.04.2024.

Duke shtuar se ka marr aktvendim pér fillim të hetimeve ndaj të pandehurit [REDACTED] pér shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, po ashtu edhe janë marr veprime të tjera hetimore, respektivisht është marr vendim pér ekzaminim të provës (DVR-it), aktvendim pér caktimin e ekspertit të balistikës e po ashtu është marr vendim pér ekzaminimin e mostrave të barotit në prova të siguruara nga i dëmtuari, duke marr disa nga deklaratat e palëve.

Po ashtu ndër tjera prokurori ka cekur se në shkresat e lëndës ekziston një propozim i përfaqësuesit të autorizuar pér rikonstruktim të vendit të ngjarjes sipas nenit 148 të KPPRK-së, dhe se varësisht nga rezultatet e provave tjera si nxjerra e video incizimeve nga DVR, do të vlerësohet propozimi i tillë.

**Të gjeturat e autoritetit kompetent;**

Autoriteti kompetent pasi që ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e paraqitura nga pala ankuese, pastaj përgjigjen apo raportin e prokurorit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me veprimet apo mosveprimet e prokurorit të çështjes, konstatohet se prokurori në lidhje me këtë çështje ka marr vendim pér caktimin e ekspertit mjekoligjor pér të paraqitur ekspertizë mjeko ligjor, po ashtu është marr aktvendim pér fillimin e hetimeve kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED], pér shkak të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 të KPRK-së, veprës penale kanosje nga neni 181 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 të KPRK-së, duke vazhduar me procedimin e palëve në procedurë si dhe veprimet e tjera dhe se trajtimi i kësaj çështje penale ka marr kohe pér shkak të ngarkesës me lëndë, sikurse ka cekur në përgjigjen e tij dhe së në vazhdim do të vendos në lidhje me propozimet e palëve në procedurë dhe përfundimin e kësaj çështje penale.

Në përfundim në bazë të cekurave më lartë, autoriteti kompetent ka vlerësuar se ankesa është e pa bazuar dhe se në rastin konkret në veprimet e prokurorit në çështjen penale konkrete, nuk ekzistojnë shkelje disiplinore konform nenit 6 par.1 dhe 2 të Ligjit pér përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u bazuar në të cekurat më lartë.

Për arsyerat e lartcekura u vendos si në dispozitiv të vendimit.

**T'i dorëzohet :**

- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- av. [REDACTED] - Njoftim me shkrim
- Shkresave të lëndës

